



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 16.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.10.2024, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **K.S. Dukagjini SH.A.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Retender - Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8439-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **K.S. Dukagjini SH.A.**, e dt.14.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Retender - Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8439-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 10.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 10.10.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **K.S. Dukagjini SH.A.**, me dt.14.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Retender - Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8439-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja lidhur me kërkesat e AK në FDT-ë, janë të pa bazuara, sepse ju keni pasur afatin ligjor për të kërkuar sqarime shtesë;

Sa i përket pretendimeve tuaja lidhur me Aneksin 6 të dosjes së tenderit dhe referencave të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë që ka me OE privat, nuk qëndrojnë, sepse i njëjti ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
